



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1058 prot.

Pukë, më 27.06.2026

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "**Për vetëqeverisjen vendore**", si dhe në përputhje me parimet e transparencës, konsultimit publik dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, **Bashkia Pukë** fton qytetarët, grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike, bizneset dhe çdo subjekt të interesuar të marrin pjesë në **Dëgjesën Publike**, e cila do të zhvillohet sipas këtij kalendarit:

 **Data:** 14 Korrik 2026

 **Ora:** 10:00

 **Vendi:** Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Bashkia Pukë

**RENDI I DITËS**

**1. Prezantimi dhe diskutimi i:**

**Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030**

Ky plan synon promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha aspektet e jetës sociale, ekonomike dhe institucionale, duke garantuar mundësi të barabarta dhe akses të barabartë në shërbimet publike.

**2. Prezantimi dhe diskutimi i:**

**Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2026–2029**

Plani i Integritetit synon forcimin e transparencës, llogaridhënies, etikës institucionale dhe parandalimin e korrupsionit në administratën vendore, duke ndërtuar një administratë më efikase, më të besueshme dhe më pranë qytetarëve.

**QËLLIMI I DËGJESES PUBLIKE**

Dëgjesa organizohet për të:

---

Adresa: Bashkia Pukë, sheshi "Gjergj Kastrioti (Skenderbeu)", e-mail: [bashkiapuke@yahoo.com](mailto:bashkiapuke@yahoo.com), faqe zyrtare [www.bashkiapuke.gov.al](http://www.bashkiapuke.gov.al)

- informuar publikun mbi përmbajtjen e dy dokumenteve strategjike;
- mbledhur mendime, sugjerime dhe rekomandime nga qytetarët dhe grupet e interesit;
- garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës në hartimin dhe miratimin e politikave vendore;
- nxitur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe komunitetit për zhvillimin e Bashkisë Pukë.

**Kontributi dhe pjesëmarrja juaj janë të rëndësishme për ndërtimin e politikave vendore që reflektojnë nevojat dhe interesin e komunitetit.**

**Ju mirëpresim në këtë dëgjese publike!**

**Për më shumë informacion:**

 [www.bashkiapuke.gov.al](http://www.bashkiapuke.gov.al)

**BASHKIA PUKË**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
SEKRETARI I KËSHILLIT

Nr. 1053 Prot.

Pukë, më 14 .07 .2026

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË DËGJESËS PUBLIKE PËR KONSULTIMIN E DOKUMENTEVE  
STRATEGJIKE TË BASHKISË PUKË

**Data:** 14.07.2026

**Ora:** 10:00 – 11:45

**Vendi:** Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Bashkia Pukë

**Drejtoi mbledhjen:**

**Z. Ferit Ringaj** – Zv. Kryetar i Bashkisë Pukë

**Procesverbal-mbajtës:**

Ndricim Asllanaj

**RENDI I DITËS**

1. Hapja e dëgjesës publike.
2. Prezantimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030.
3. Prezantimi i Planit Vendor të Integritetit të Bashkisë Pukë 2026–2029.
4. Diskutime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit.
5. Konkluzione dhe mbyllja e dëgjesës.

**PJESËMARRËS**

Në dëgjesën publike morën pjesë:

- drejtues të Bashkisë Pukë;
- drejtues drejtorish dhe sektorësh;
- anëtarë të Këshillit Bashkiak;
- përfaqësues të institucioneve publike;
- përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- përfaqësues të biznesit lokal;

- qytetarë;
- media lokale.

Pas verifikimit të pjesëmarrjes, u konstatua se dëgjesa mund të zhvillohej normalisht.

## HAPJA E MBLEDHJES

Mbledhja u hap nga **Zv. Kryetari i Bashkisë Pukë, z. Ferit Ringaj**, i cili falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen.

Në fjalën e tij ai theksoi:

"Bashkia Pukë ka zgjedhur të ndërtojë politikat e saj mbi dialogun me komunitetin. Dokumentet që prezantojmë sot nuk janë thjesht dokumente administrative, por instrumente strategjike që do të ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si administrata do të ushtrojë funksionet e saj gjatë viteve në vijim.

Qeverisja vendore nuk mund të jetë efektive pa pjesëmarrjen e qytetarëve. Pikërisht për këtë arsye kemi organizuar këtë dëgjese publike, në mënyrë që secili të ketë mundësinë të japë mendimin e tij dhe të kontribuojë në përmirësimin e këtyre dokumenteve.

Integriteti institucional dhe barazia gjinore nuk janë vetëm objektiva të Bashkisë, por janë vlera themelore të një administrate moderne, transparente dhe në shërbim të qytetarit."

Ai ftoi pjesëmarrësit që diskutimet të jenë konstruktive dhe çdo rekomandim të mbështetet në argumente konkrete.

## PIKA E PARË

### Prezantimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030

Relacionin e paraqiti **znj. Lavdie Terbuni**, Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike, Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimit Social.

Ajo bëri një prezantim të detajuar të dokumentit, duke theksuar se:

- dokumenti është hartuar mbi analizën e situatës sociale të Bashkisë Pukë;
- është konsultuar me institucionet vendore dhe aktorët lokalë;
- është ndërtuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore.

Sipas saj:

"Ky plan synon të krijojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në jetën ekonomike, sociale, politike dhe institucionale. Ai nuk është vetëm një dokument social, por një instrument zhvillimi për të gjithë komunitetin."

Më tej znj. Terbuni prezantoi katër objektivat strategjike të planit, masat konkrete, institucionet përgjegjëse, indikatorët dhe afatet e zbatimit.

Ajo theksoi se një rëndësi e veçantë i është kushtuar:

- fuqizimit ekonomik të grave;
- përfshirjes së grave në vendimmarrje;
- mbështetjes së viktimave të dhunës;
- ndërgjegjësimit të komunitetit.

## **PIKA E DYTË**

### **Prezantimi i Planit Vendor të Integritetit 2026–2029**

Relacionin e paraqiti **z. Sokol Gjoni**, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Në prezantimin e tij ai u shpreh:

"Integriteti institucional nuk ndërtohet vetëm përmes ligjeve. Ai ndërtohet çdo ditë në marrëdhënien që administrata krijon me qytetarin.

Një administratë me integritet është një administratë që vepron me profesionalizëm, paanshmëri, transparencë dhe përgjegjësi."

Ai paraqiti procesin e hartimit të dokumentit dhe punën e Grupit të Punës, duke shpjeguar analizën e risqeve, objektivat strategjike dhe masat parandaluese.

Në vijim ai prezantoi tre objektivat strategjike të Planit:

- forcimin e kulturës së integritetit institucional;
- rritjen e transparencës dhe llogaridhënies;
- përmirësimin e kontrollit të brendshëm, administrimit të riskut dhe performancës institucionale.

Ai theksoi se:

"Plani nuk është hartuar për të shtuar burokracinë, por për të krijuar mekanizma që ndihmojnë administratën të parandalojë problematikat përpara se ato të shfaqen."

Në fund të prezantimit u shpjeguan mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe publikimit të rezultateve.

## **DISKUTIMET**

Pas përfundimit të prezantimeve u hap diskutimi.

### **Diskutimi 1**

Një përfaqësuese e organizatave të shoqërisë civile përshëndeti iniciativën e Bashkisë dhe propozoi që monitorimi i Planit të Barazisë Gjinore të shoqërohet me takime të rregullta me komunitetin.

Relatorja znj. Lavdie Terbuni e mirëpriti sugjerimin dhe deklaroi se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile do të jetë pjesë e mekanizmave të monitorimit.

### **Diskutimi 2**

Një përfaqësues i biznesit lokal sugjeroi zgjerimin e transparencës mbi procedurat administrative dhe publikimin periodik të raporteve mbi zbatimin e Planit të Integritetit.

Z. Sokol Gjoni sqaroi se:

Plani parashikon publikimin e raporteve të monitorimit dhe informimin periodik të publikut në faqen zyrtare të Bashkisë."

### **Diskutimi 3**

Qytetari Pashk Kola propozoi që Bashkia të organizojë më shumë aktivitete ndërgjegjëse në shkolla mbi barazinë gjinore dhe etikën qytetare.

Sugjerimi u mirëprit dhe u konsiderua si një masë që mund të përfshihet në programet vjetore të aktiviteteve.

### **Diskutimi 4**

Aleksander Shabani, perfaqësues nga shoqëria civile kërkoi që raportet mbi zbatimin e të dy planeve të bëhen të njohura në web-in zyrtar të bashkisë për arsye aksesueshmërie.

Zv. Kryetari Ferit Ringaj deklaroi se:

"Llogaridhënia është pjesë e vetë filozofisë së këtyre dokumenteve dhe raportimi periodik do të garantohej përmes mekanizmave të monitorimit të parashikuar."

### **Diskutimi 5**

Përfaqësues të administratës propozuan zhvillimin e trajnimeve periodike për etikën në administratë dhe konfliktin e interesit.

Propozimi u mbështet unanimisht.

## **KONKLuzionET**

Në përfundim të diskutimeve u konstatua se:

- pjesëmarrësit vlerësuan pozitivisht të dy dokumentet strategjike;
- u mbështet miratimi i tyre nga Këshilli Bashkiak;
- sugjerimet e paraqitura do të analizohen nga grupet përkatëse të punës dhe, kur të jenë në përputhje me objektivat e dokumenteve, do të reflektohen në versionin përfundimtar;
- u vlerësua se procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ka garantuar transparencë, pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje.

Në mungesë të diskutimeve të tjera, Zv. Kryetari i Bashkisë falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe deklaroi të mbyllur dëgjuesën publike në orën **11:45**.

## **MBAJTI PROCESVERBALIN**

NDRIÇIM ASLLANAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
SEKRETARI I KËSHILLIT

Nr. 1058/prot.

Pukë, më 14.07.2026

RELACION

**MBI ZHVILLIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR KONSULTIMIN E DOKUMENTEVE  
STRATEGJIKE TË BASHKISË PUKË**

**"Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030" dhe "Plani Vendor i Integritetit 2026–2029"**

**I. Baza ligjore**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe në zbatim të parimeve të transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe qeverisjes së mirë, Bashkia Pukë organizoi më **14 korrik 2026**, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, dëgjesën publike për konsultimin e dy dokumenteve strategjike:

- **Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030;**
- **Planit Vendor të Integritetit 2026–2029 të Bashkisë Pukë.**

Qëllimi i kësaj dëgjese ishte garantimi i një procesi të hapur konsultimi, përfshirja aktive e qytetarëve dhe aktorëve të interesit në hartimin e politikave vendore, si dhe përmirësimi i dokumenteve strategjike përpara miratimit të tyre nga Këshilli Bashkiak.

**II. Organizimi i dëgjesës**

Në zbatim të njoftimit publik të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Pukë dhe në rrjetet sociale institucionale, në dëgjesë morën pjesë:

- përfaqësues të administratës së Bashkisë;
- anëtarë të Këshillit Bashkiak;
- drejtues të drejtorive;
- përfaqësues të institucioneve publike;
- organizata të shoqërisë civile;
- përfaqësues të biznesit;
- qytetarë të Bashkisë Pukë;

- media lokale.

Takimi u drejtua nga **Zv. Kryetari i Bashkisë Pukë, z. Ferit Ringaj**, në cilësinë e drejtuesit të Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit.

### III. Hapja e dëgjësës

Në fjalën e tij përshëndetëse, **z. Ferit Ringaj** theksoi se konsultimi publik nuk duhet parë vetëm si një detyrim ligjor, por si një standard i domosdoshëm i qeverisjes demokratike.

Ai u shpreh se Bashkia Pukë ka zgjedhur që dokumentet strategjike të mos hartohen në mënyrë të mbyllur nga administrata, por të ndërtohen mbi dialogun me komunitetin.

Sipas tij:

"Një dokument strategjik është aq i mirë sa është edhe pjesëmarrja që ka shoqëruar hartimin e tij. Pikërisht për këtë arsye ne kemi zgjedhur që qytetarët të jenë pjesë e këtij procesi që në fazën e konsultimit."

Ai nënvizoi se dokumentet që prezantohen nuk janë dokumente formale, por instrumente konkrete pune që do të udhëheqin veprimtarinë e Bashkisë gjatë viteve të ardhshme.

Zv. Kryetari evidentoi se Plani Vendor për Barazinë Gjinore synon të krijojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha fushat e jetës, ndërsa Plani Vendor i Integritetit synon forcimin e kulturës së integritetit institucional, transparencës dhe përgjegjshmërisë në administratën vendore.

Në përfundim ai ftoi të gjithë pjesëmarrësit të japin mendime konkrete dhe sugjerime të argumentuara, duke garantuar se çdo rekomandim do të analizohet me seriozitet përpara miratimit të dokumenteve.

### IV. Prezantimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030

Në vijim të rendit të ditës, relativimin e parë e mbajti **znj. Lavdie Terbuni**, Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike, PAK dhe Shërbimit Social.

Ajo paraqiti në mënyrë të detajuar strukturën e Planit Vendor për Barazinë Gjinore, duke evidentuar se dokumenti është ndërtuar mbi analizën e situatës sociale të Bashkisë Pukë dhe mbi prioritetet kombëtare për barazinë gjinore.

Në prezantimin e saj u theksua se objektivat kryesore të planit janë:

- rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje;
- fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave;
- lufta kundër dhunës me bazë gjinore;
- garantimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike;
- rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për barazinë gjinore.

Ajo shpjegoi gjithashtu masat konkrete që Bashkia Pukë do të ndërmarrë gjatë periudhës 2026–2030, duke theksuar se dokumenti përmban indikatorë të matshëm dhe mekanizma monitorimi.

Më pas relativisht e dytë e mbajti **z. Sokol Gjoni**, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe anëtar i Grupit të Punës për hartimin e Planit të Integritetit.

Në fjalën e tij ai theksoi se integriteti institucional nuk lidhet vetëm me parandalimin e korrupsionit, por përfaqëson tërësinë e standardeve profesionale dhe morale mbi të cilat funksionon administrata publike.

Ai evidentoi se:

"Integriteti nuk është thjesht një dokument. Integriteti është mënyra se si sillet administrata çdo ditë ndaj qytetarit. Ai matet me transparencën, paanshmërinë, profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë në çdo vendim administrativ."

Më tej ai paraqiti objektivat strategjike të Planit:

- forcimin e kulturës së integritetit institucional;
- përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator;
- rritjen e transparencës dhe llogaridhënies;
- forcimin e kontrollit të brendshëm;
- administrimin e riskut;
- përmirësimin e performancës institucionale.

Gjithashtu u shpjeguan mekanizmat e monitorimit, përgjegjësit institucionale dhe indikatorët që do të përdoren për matjen e progresit gjatë zbatimit të planit.

## **VI. Diskutimet**

Pas prezantimeve u zhvillua një diskutim i hapur.

Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile vlerësuan faktin që Bashkia kishte hartuar dokumente me objektiva të matshëm dhe kërkuar që raportet e monitorimit të publikohen periodikisht.

Përfaqësues të biznesit propozuan forcimin e transparencës në komunikimin me subjektet ekonomike dhe zgjerimin e shërbimeve elektronike.

Një qytetare propozoi organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në shkolla dhe komunitet.

Një përfaqësues i institucioneve publike sugjeroi që për Planin e Integritetit të organizohen trajnime periodike për administratën mbi etikën dhe konfliktin e interesit.

Këshilltarët bashkiakë vlerësuan cilësinë e dokumenteve dhe rekomanduan që monitorimi i tyre të raportohet rregullisht edhe pranë Këshillit Bashkiak.

---

## **VII. Përfundimet**

Në përfundim të dëgjësës publike u konstatua se:

- pjesëmarrësit mbështetën miratimin e të dy dokumenteve;
- nuk pati kundërshtime mbi përmbajtjen e tyre;
- sugjerimet e paraqitura do të reflektohen në versionin përfundimtar, sipas rastit;
- dokumentet konsiderohen të plota dhe të gatshme për t'iu paraqitur Këshillit Bashkiak për miratim.

Procesi i konsultimit publik u zhvillua në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standardet e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe qeverisjes së mirë.

**Përgatiti:**

**Përgatiti relacionin**

SEKRETARI I KËSHILLIT

NDRIÇIM ASLLANAJ

